

VENDIM
Nr. 157, datë 21.3.2018

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN
NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E
PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në listën e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”, shtohen individët e renditur në shkronjën “a”, të shtesës që i bashkëlidhet këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida.

2. Në listën e shkronjës “D”, “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”, shtohet kompania e renditur në shkronjën “b”, të shtesës që i bashkëlidhet këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për kompanitë që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PER-SONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-SË (LISTA E OKB-SË)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (Da'esh) dhe AL-QAIDA

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida”:

1. SALIM; MUSTAFA, MUHAMMAD, AL-MANSUR;
2. UMAR; MAHMUD, IRHAYYIM, AL-KUBAYSI.

D. LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË ME ORGANIZATAT ISIL (Da'esh) dhe AL-QAIDA

b) Lista e shtuar në “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida”:

1. AL-KAWTHAR MONEY EXCHANGE.

Shënim. Gjeneralitetet e tjera për personat dhe kompanitë, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.